

**MBI LICENCIMIN E SHOQËRISË “DELTA PLAN STUDIO” SHPK NË
VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, 37, pika 2, germa “a”, 38, pika 1, germa “a”, dhe 39, pika 4, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 4, pika 1, germa “a”, 5, pika 1, germa “a”, 13 dhe 14, pika 9, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, e ndryshuar; si dhe nenit 15 të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e datës 5.11.2024, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1968/7 prot., datë 31.10.2024, të Drejtorisë së Licencimit dhe Autorizimeve “Mbi kërkesën e shoqërisë ‘Delta Plan Studio’ sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Delta Plan Studio” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1968 prot., datë 25.9.2024, paraqiti kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltai me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 209, datë 7.10.2024, vendosi të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë në këtë veprimtari.

- ERE botoi njoftimin në median e shkruar për fillimin e kësaj procedure (në datat 8.10.2024 dhe 9.10.2024) dhe në përfundim të afatit të pritjes së komenteve apo objeksioneve nga të tretët (data 17.10.2024), nuk rezultoi të ketë të tilla. Njoftimi për fillimin e procedurës u botua edhe në faqen zyrtare të internetit të ERE-s.

- Gjithashtu, ERE me shkresën nr. 2105 prot., datë 11.10.2024, ka njoftuar Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë (MIE) për fillimin e kësaj procedure.

- Me shkresën nr. 1968/3 prot., datë 10.10.2024, ERE i është drejtuar shoqërisë duke i njoftuar vendimin e fillimit të procedurës dhe informacionin/dokumentacionin që nevojitet të plotësohet më tej për këtë aplikim.

- Me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1968/4 prot., datë 11.10.2024, shoqëria ka depozituar informacion dhe dokumentacion plotësues për aplikimin, nga shqyrtimi i të cilit ka rezultuar se ka ende dokumentacion që nevojitet të plotësohet, ndaj ERE-s iu drejtua shoqërisë me e-mailin e datës 25.10.2024. Shoqëria, me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 1968/6 prot., datë 28.10.2024, ka depozituar dokumentacionin e kërkuar.

- Nga analizimi i aplikimit, në referencë të përcaktimeve të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, rezulton se shoqëria ka kryer pagesën e aplikimit sipas përcaktimeve të aneksit A dhe ka plotësuar dokumentacionin e kërkuar në zbatim të nenit 9, për pikën 1.1, germat “a” “b” dhe “c”; për pikën 1.2, germat “a”, “b”, “c” dhe “d”; për pikën 1.3, germat “a”, “b” dhe “c”; për pikën 2.1 germat “a”, “b”, “c”, “d”, “e” dhe “f”.

- Rezulton se shoqëria “Delta Plan Studio” sh.p.k.:

- Ka nënshkruar me MIE-n Kontratën nr. 2058 rep., nr. 642 kol., datë 23.5.2024, “Për ndërtimin, shfrytëzimin dhe administrimin e centralit gjenerues të energjisë elektrike fotovoltaike, me kapacitet prodhues 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, në fshatin Povelce, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, qarku Fier, nga shoqëria ‘Delta Plan Studio’ sh.p.k.”;

- Ka marrë miratimin për pikën e lidhjes së centralit fotovoltai me rrjetin e shpërndarjes dhe ka depozituar në ERE shkresën e shoqërisë së Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) sh.a. “Miratim pikë lidhjes centrali fotovoltai “Delta Solar Park”, me nr. 7330/3 prot., datë 6.9.2023;

- Është pajisur me vendim për VNM paraprahe, lëshuar më 18.12.2023 nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit (AKM), për të zhvilluar projektin “Ndërtimi i centralit fotovoltaiik Delta Solar Park, 2 mw”. Kjo VNM është e vlefshme deri më 18.12.2025 dhe referuar faktit që shoqëria ka informuar se është në proces për t’u pajisur me lejet e nevojshme për fillimin e punimeve, vlerësohet t’i lihet kusht që të dokumentojë në ERE fillimin e punimeve jo më vonë se data 18.12.2025, ose duhet të depozitojë në ERE një VNM të re.

- ERE, në zbatim të nenit 38, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nenit 5, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin, njohjen dhe heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, lëshon një licencë për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike deri në 30 vjet. Rezulton se shoqëria ka depozituar në ERE një dokument teknik (garanci e paneleve), ku përcaktohet se garancia e tyre është për 30 vjet e po ashtu nga plani i biznesit rezulton se shoqëria ka bërë vlerësimin/parashikimin për operimin e centralin për 30 vjet, ndaj dhe afati i licencës vlerësohet të jetë për 30 vjet.

- Në referencë të përcaktimeve të nenit 9 të kontratës me nr. 2058 rep., nr. 642 kol., datë 23.5.2024 të nënshkruar me MIE-n, shoqëria duhet të fillojë punimet brenda 90 ditëve nga pajisja me të gjitha lejet (me të cilat ka njoftuar nuk është pajisur akoma) dhe se do të vendosë në punë centralin brenda 36 muajve nga pajisja me këto leje. Në këto rrethana, vlerësohet që në vendimin e licencimit të përcaktohet që shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e veprimtarisë së prodhimit të energjisë elektrike brenda afateve të kësaj kontrate.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të licencojë shoqërinë “Delta Plan Studio” sh.p.k. në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik me kapacitet të instaluar 2 mw, në zonën kadastrale nr. 3038, fshati Povelçë, Njësia Administrative Dërmenas, Bashkia Fier, për një afat 30-vjeçar.

2. Shoqëria duhet të dokumentojë fillimin e punimeve për ndërtimin e centralit fotovoltaiik brenda afatit të fundit të vlefshmërisë së VNM-së paraprahe (brenda datës 18.12.2025), ose duhet të depozitojë në ERE një VNM paraprahe të re.

3. Shoqëria duhet të fillojë ushtrimin e aktivitetit të prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaiik, brenda afateve të përcaktuara në kontratën me MIE.

4. Ky vendim është objekt rishikimi nga ERE.

5. Drejtoria e Licencimit dhe Autorizimeve, të njoftojë shoqërinë “Delta Plan Studio” sh.p.k., Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë, shoqërinë “Operatori i Sistemit të Shpërndarjes” sh.a. dhe shoqërinë “Furnizuesi i Tregut të Lirë” sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti